

RAPORTI MBI PËRFSHIRJEN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË AXHENDËN E FUSHATËS ELEKTORALE DHE NË PROCESIN ZGJEDHOR TË 25 PRILLIT 2021

Ky raport është hartuar në kuadrin e projektit “Zgjedhje Gjithëpërfshirëse” të financuar nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Përmbajta dhe pikëpamjet e shprehura janë të autorit.

Në raport u analizuan vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe takimet elektorale gjatë fushatës të 4 subjekteve politike PS, PD, LSI dhe NTH. Raporti u përgatit nga Msc. Evis Nasto.

Ky botim u përgatit përmes projektit “Zgjedhje Gjithëpërfshirëse” të financuar nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Përmbajta dhe pikëpamjet e shprehura janë të autorit.

Tabela e përmbajtjes

	Lista e Figurave.....	4
	Shkurtime	5
I.	Hyrja	6
	1.1 Sfondi ligjor i të drejtave politike të Personave me Aftësi të Kufizuara.....	6
	1.2 Konteksti i zhvillimit të fushatës elektorale.....	7
II.	Metodologjia	9
III.	Vendimet e KQZ për aksesin e Personave me Aftësi të Kufizuara në zgjedhje.....	10
	3.1 Përgatitja e QV për zgjedhësit me aftësi të kufizuara.....	10
	3.2 Çrregjistrimi i kandidatëve me aftësi të kufizuara nga listat për deputetë	13
IV.	Çështje të Aftësisë së Kufizuar në fushatën elektorale	15
V.	Personat me Aftësi të Kufizuara në listat e kandidatëve	22
VI.	Konkluzione	26
VII.	Rekomandime.....	27
	Referenca	28

Lista e Figurave

Figura 1.	Foto e shabllonit të prodhuar të fletës së votimit për të verbërit	12
Figura 2.	Paraqitja grafike e frekuencës së takimeve elektorale	16
Figura 3.	Tabela e takimeve elektorale të bëra publike nga PD	18
Figura 3.1.	Vijon tabela e takimeve elektorale të bëra publike nga PD	19
Figura 4.	Tabela e takimeve elektorale të bëra publike nga PS	20
Figura 5.	Tabela e takimeve elektorale të bëra publike nga LSI	21
Figura 6.	Tabela e takimeve elektorale të bëra publike nga NTH.....	21

Shkurtimet

RSH	Republika e Shqipërisë
KDPAK	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
KMCAP	Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KEMP)
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KZAZ	Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor
QV	Qendra e Votimit
PSSH	Partia Socialiste e Shqipërisë
PDSH	Partia Demokratike e Shqipërisë
LSI	Lëvizja Socialiste për Integrim
NTH	Nisma Thurje
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
INSTAT	Instituti i Statistikave
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OPAK	Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuar
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
ODHIR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
PPAK	Partia e Personave me Aftësi të Kufizuara

I. HYRJJE

1.1 Sfondi Ligjor i të drejtave politike të Personave me Aftësi të Kufizuara

Njerëzit me Aftësi të Kufizuara përfaqësojnë një grupim social heterogjen por të konsiderueshëm. Në Shqipëri janë të njohur zyrtarisht, referuar të dhënave statistikore të MSHMS, 148,544 persona që kanë një aftësi të kufizuar, por ende nuk ka një bazë të dhënash të saktë dhe të unifikuar në listat e zgjedhësve për numrin e atyre që marrin pjesë në votime. Në vitet e fundit është rritur ndërgjegjësia publike për rëndësinë e përfshirjes së tyre në proceset politike, si rrjedhojë e njohjes së një seri të drejtash, mes të cilave dhe ajo për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur si përfaqësues të popullit në parlament. Të drejta që mbrohen nga disa dokumenta ndërkombëtarë, ndër më kryesoret mes tyre: Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, e ratifikuar edhe nga parlamenti i Republikës i Shqipërisë. Në nenin 29 të saj, garantohen të drejtat politike të këtij komuniteti duke u kërkuar shteteve të sigurojnë kushtet për zbatimin e tyre, me qëllim që Personat me Aftësi të Kufizuara "të marrin pjesë në zgjedhje, të kenë funksione publike në të gjitha nivelet e qeverisë, si dhe t'u lehtësohet përdorimi i asistuar i teknologjive të reja aty ku është e përshtatshme." Në frymën e KDPAK, kjo e drejtë politike është njohur edhe në Kodin Zgjedhor të RSH, përkatësisht në nenin 108, ku përcaktohet detyrimi nga institucionet shtetërore për ngritjen e qendrave të votimit të përshtatura për Personat me Aftësi të Kufizuara. Kjo dispozitë ka qenë objekt i diskutimeve nga KQZ dhe grupet e interesit për t'u nënshtruar ndryshimeve me qëllim nxitjen e institucioneve për të marrë masa konkrete në drejtim të:

- ◆ Identifikimit të saktë të zgjedhësve që janë pjesë e këtij komuniteti që në çdo qendër votimi ku ato janë të regjistruar për të votuar;
- ◆ Krijimin kushteve të përshtatshme që mundësojnë pjesëmarrjen në proces sipas llojit të aftësisë së kufizuar.

Pavarësisht diskutimeve, kjo dispozitë nuk ka qenë pjesë e reformës zgjedhore të kryer 3 herë brenda këtyra 10 viteve të fundit (2012, 2015, 2020) duke mos marrë në konsideratë as rekomandimet e OSBE-ODHIR për të korigjuar mangësitë e identifikuar në aksesin e Personave me Aftësi të Kufizuara ditën e votimit. Rekomandimet më

të fundit të këtij misioni i takojnë zgjedhjeve parlamentare pararendëse të Qershorit 2017-të, për të cilat OSBE-ODHIR evidenton në raportin final se *“në dy të tretat e qendrave të votimit të vëzhguara nuk u lejua akses i pavarur i zgjedhësve me aftësi të kufizuara, ndërsa sistemimi i mjedisit të brendshëm të qendrave të votimit nuk ishte i përshtatshëm për aksesin e tyre në 34 për qind të vëzhgimeve, duke mos garantuar plotësisht të drejtën e barabartë të votes”*¹ Në raport nxirret në pah edhe një aspekt kritik në historinë e proceseve elektorale shqiptare që ka të bëjë me *“kufizimin e të drejtës së votës për shtetasit që janë shpallur të paaftë mendërisht me vendim gjykatë.”*² Diçka e tillë, sikurse vëren OSBE-ODHIR, bien ndesh me detyrimet ndërkombëtare që ndalojnë diskriminimin për shkak të paaftësisë, duke iu referuar për këtë konkretisht dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990 thotë: *“Të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe gëzojnë të drejtë pa diskriminim për mbrojtje të barabartë nga ligji”*. Për sa më sipër, OSBE-ODHIR rekomandoi heqjen e këtij kufizimi për shkak të paaftësisë si dhe marrjen e masave nga autoritetet për të lehtësuar pjesëmarrjen e pavarur në procedurat e votimit të zgjedhësve me aftësi të kufizuara.

1.2 Konteksti i Zhvillimit të Fushatës Elektorale

Një nga aspektet kryesore në procesin demokratik zgjedhor, i prekur ngushtësisht nga pandemia, është fushata zgjedhore. Edhe pse konsiderohet si mundësi për partitë politike që të prezantojnë idetë e tyre për mënyrën sesi politikatat publike duhet të ndryshojnë apo të qëndrojnë njësoj, prej më shumë se një viti, takimet elektorale konsiderohen edhe si formë e përhapjes së COVID-19. Vendimi në fuqi i Komitetit Teknik të Ekspertëve në lidhje me ndalimin e grumbullimeve prej më shumë se 10 personash, në kuadër të masave të marra për frenimin e përhapjes së infeksionit në RSH, shkaktoi jo pak debate që në fund të vitit 2020 pasi takimet elektorale nisën të bëheshin më të shpeshta pavarësisht faktit se fushata zyrtarisht nuk kishte filluar akoma. Madje një nga forcat politike opozitare, Partia Republikane depozitoi në 4 Dhjetor 2020 një padi në Gjykatën Kushtetuese, duke kërkuar rrëzimin dhe shfuqizimin e urdhrit të Komitetit Teknik të Ekspertëve të datës 17 nëntor 2020. Padia u argumentua nga përfaqësuesi ligjor i Partisë Republikane me *“dëmtimin e rëndë që i sjell akt-objekti i kërkesës (ndalimi i grumbullimit masiv të qytetarëve) fushatës për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të 25 Prillit, në veçanti partive opozitare në përmbushjen e rolit të tyre Kushtetues si parti politike.”*³

-
1. Raporti i OSBE-ODHIR për zgjedhjet parlamentare të 25 Qershorit 2017/ Hapja dhe Votimi, fq. 24.
 2. Raporti i OSBE-ODHIR për zgjedhjet parlamentare të 25 Qershorit 2017/Rregjistrimi i zgjedhësve, fq.11.
 3. Padia e PR në Gjykatën Kushtetuese e bërë publike në media, <https://top-channel.tv/2021/03/09/tubimet-elektorale-gjykata-kushtetuese-pranon-pjeserisht-kerkesen-e-pr4/>

Kjo ishte çështja e parë që u shqyrtua nga Gjykata Kushtetuese e sapongritur pas procesit të vettingut në drejtësi. Në vendimin e datës 9 Mars 2021, Gjykata Kushtetuese pranoi pjesërisht kërkesën e Partisë Republikane për të zhvilluar tubimet elektorale. Sipas Gjykatës Kushtetuese, Ministria e Shëndetësisë duhet të rishikonte masat kufizuese të pandemisë brenda një jave dhe të shpallte vendimin. Gjykata shfuqizoi “shprehjen deri në një urdhër të dytë” të Ministrisë së Shëndetësisë. Dy javë pas këtij vendimi, në mbledhjen periodike të Komitetit Teknik të Ekspertëve u vendos të liheshin në fuqi masat kufizuese që ndalojnë grumbullimet masive, duke iu apeluar përvojës së vendeve që kanë kryer më herët zgjedhjet në pandemi dhe nuk kanë pasur shtim të infeksionit. Situata epidemiologjike referuar burimeve zyrtare të MSHMS është paraqitur e qëndrueshme gjatë fushatës dhe me tregues në rënie të përhapjes së infeksionit të COVID-19, megjithatë kjo nuk çoi në heqjen e kufizimeve për grumbullimet masive. Ruajtja e distancës dhe mbajtja e maskës në takime elektorale u kthye në një motiv më shumë për propagandë politike mes Partisë Socialiste dhe koalicionit të partive opozitare të udhëhequra nga PD, por jo në një pengesë reale për të zhvilluar tubimet elektorale, madje edhe me pjesëmarrje masive

II. METODOLOGJIA

Raporti kërkimor është mbështetur në metodologjinë kërkimore cilësore, në të cilën janë përcaktuar indikatorët dhe burimet e vlerësimit të tyre. Për të pasur një tablo të plotë dhe të vërtetë në lidhje me përfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në fushatën elektorale të zgjedhjeve të 25 Prillit, analiza u përqëndrua në vëzhgimin e aktiviteteve elektorale të 4 subjekteve politike PS, PD, LSI dhe NTH, ku për çdo aktivitet zgjedhor u evidetuan këto aspekte:

- ◆ Vlerësimi i pjesëmarrjes së Personave me Aftësi të Kufizuara në aktivitete elektorale
- ◆ Kandidatët me të cilët prezantohet subjekti politik
- ◆ Problemet e trajtuara nga pjesëmarrësit në aktivitetet
- ◆ Niveli i vëmendjes që zënë në platformat elektorale problemet e kësaj kategorie sociale dhe zgjidhjet që ofrohen

Strategjia kërkimore eksploruese konsiston në: a) punën kërkimore të dokumentave me natyrë ligjore të lidhura me vendimmarrjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve sa i takon përfshirjes së Personave me Aftësi të Kufizuara në procesin zgjedhor b) identifikimin në listat e partive politike të kandidatëve me aftësi të kufizuara. Për këtë të fundit, puna kërkimore është udhëhequr nga kërkimet me burime jozyrtare, jo vetëm për shkak të një pranie shumë të vogël të Personave me Aftësi të Kufizuara në listat e partive por edhe prej refuzimit që rastet e rralla të kandidimit nga ky komunitet i bëjnë aftësisë së tyre të kufizuar. Ata nuk pranojnë të identifikohen si pjesë e këtij grupimi social. Në funksion të përmbushjes së këtij aspekti kërkimor janë intervistuar në kushtet e ruajtjes së anonimatit, 2 kandidatë, një prej të cilëve është çrregjistruar bashkë me subjektin politik në garë. Pavarësisht kësaj përfshirja e tij në këtë studim shihet me interes në aspektin sfidave me të cilat duhet të përballlet një personi me aftësi të kufizuara që vendos të angazhohet politikisht në Shqipëri. Informacioni i nevojshëm, në kuadër të studimit, është hulumtuar me përpikmëri nga ana e kërkuesit, duke mbajtur në konsideratë çështjet etike, një element kyç për integritetin profesional të një raporti kërkimor, sidomos kur bëhet fjalë për tematika me një ndjeshmëri të lartë.

III. VENDIMET E KQZ PËR AKSESIN NË ZGJEDHJE TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

3.1 Përgatitja e QV për zgjedhësit me aftësi të kufizuara

Në zbatim të nenit 108 të Kodit Zgjedhor, KQZ, sikurse në çdo proces zgjedhor pararendës, ka miratuar edhe për zgjedhjet parlamentare të 25 Prillit 2021, disa akte nënligjore, të cilat detajojnë procedurat dhe hapat që duhet të ndërmarrin institucionet përgjegjëse për caktimin e qendrave të votimit për të krijuar kushte të përshtatshme për aksesin e Personave me Aftësi të Kufizuara në ditën e votimit. Referuar Kodit Zgjedhor, institucionet përgjegjëse për krijimin e këtyre kushteve janë njësitë administrative, bashkitë dhe KQZ-ja. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka nxjerrë në 5 Dhjetor 2020 udhëzimin e parë për përcaktimin e rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së QV-së. Në nenin 5 të këtij udhëzimi ka një dispozitë specifike që ngarkon me përgjegjësi të drejtpërdrejtë kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore për të marrë masa në lidhje me krijimin e lehtësirave për votimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.⁴ Kodi Zgjedhor u njeht Personave me Aftësi të Kufizuara të drejtën që të regjistrohen pranë njësisë së qeverisjes vendore, si zgjedhës që nuk mund të votojnë vetë. Për të kryer këtë regjistrim, ata do të duhet të paraqesin dokumenta që provojnë llojin dhe kategorinë e paafëtisë. Identifikimi i tyre duhet të kryhet brenda periudhës së rishikimit të listave të zgjedhësve dhe kjo bëhet për t'i krijuar lehtësi votimi kësaj kategorie zgjedhësisht. Pika 7 e nenit 108 të Kodit Zgjedhor e specifikon qartësisht detyrimin ligjor që njëzia vendore ka për çdo zgjedhës që është regjistruar si i pamundur për të votuar vetë:

- ◆ “Caktimi i QV dhe organizimi i saj bëhen në mënyrë të tillë që të garantojë hyrjen e lirë për zgjedhësit me aftësi të kufizuar dhe në rast se kjo është e pamundur atëherë kryetarët e njësisë të qeverisjes vendore caktojnë personel dhe pajisje ndihmëse për ta ta garantuar atë, masa të cilat janë të mbuluara financiarisht nga shpenzimet e KQZ.”

Përpos nxjerrjes së udhëzimeve për krerët e njësisë vendore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është përgjegjës për edukimin e zgjedhësve me një vëmendje të veçantë

4. Pika 3/b e nenit 5 të Udhëzimit nr.1 Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet, 05 Dhjetor 2020.

për ata që janë me aftësi të kufizuara. Për këtë KQZ ka publikuar 4 spote informuese të përshtatura me gjuhën e shenjave për identifikimin elektronik të votuesve,⁵ veprat penale që çënojnë zgjedhjet e këtij viti⁶ procedurat e votimit,⁷ dhe KQZ – fleta e votimit.⁸ Pjesë e rëndësishme në punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për garantimin e ushtrimit të të drejtës së votimit në mënyrë të fshehtë dhe të pavarur për Personat me Aftësi të Kufizuara janë gjithashtu dhe:

- ◆ përgatitja e dhomës së fshehtësisë së posaçme për këtë kategori
- ◆ përgatitja dhe shpërndarja e materialeve zgjedhore të posaçme për zgjedhësit e verbër.

Sekretari i Përgjithshëm i KQZ, z. Ylli Merkaj, i është përgjigjur kërkesës për të ofruar informacion në lidhje me procesin parapërgatitor në funksion të përbushjes së detyrimeve të sipërpërmendura. Në mungesë të një baze të saktë të dhënash sa i takon numrit të zgjedhësve me aftësi të kufizuara në çdo Qendër Votimi, KQZ i është dashur të përgatisë bazën materiale të posaçme për këtë kategori votuesish në të 5199 QV-të që do të jenë funksionale në gjithë Republikën e Shqipërisë në 25 Prill. Pra, në secilën prej tyre do të ketë nga një dhomë e fshehtë për votuesit me aftësi të kufizuar (para dhe tetra plegjikë) dhe një shabllon të fletës së votimit për votuesit e verbër. Z. Merkaj bën me dije se ashtu sikurse ka ndodhur edhe në zgjedhjet pararendëse, procedura prokuruese për zgjedhjen e kompanisë që do të prodhojë shabllonet e fletës së votimit për zgjedhësit e verbër, është e lidhur ngushtësisht me procesin e përzgjedhjes së kompanisë që do të prodhojë të gjitha fletët e votimit. Pra thënë ndryshe, kompania që prodhon fletët e votimit është e njëjta që do të prodhojë dhe shabllonet e sipërpërmendura.

Për këto zgjedhje kompania që do të prodhojë fletët e votimit dhe shabllonet për votuesit e verbër është shoqëria slovene “Cetis d.d”, e njëjta kompani që ka prodhuar këto artikuj në zgjedhjet e viti 2013, 2015 dhe në 2019-ën. Pavarësisht vonesës që solli problemi teknik me shtypjen e fletës së votimit, që diktoi dhe nevojën e ndryshimit të identifikimit të kandidatëve për deputetë nga emra në numra rendorë, sërish burime zyrtare të KQZ konfirmojnë se ka nisur prodhimi i shabllonëve për fletët e votimit të posaçme për votuesit që nuk shikojnë. Njëmbëdhjetë ditë nga data 22 Prill, afati i vendosur për kompaninë slovene për dorëzimin e materialeve zgjedhore,


5. <https://www.youtube.com/watch?v=RXkn-0PIU80>

6. <https://www.youtube.com/watch?v=S5lq91h9aL8>

7. <https://www.youtube.com/watch?v=uHlNp7vBXjs>

8. <https://www.youtube.com/watch?v=2n7dscRR7HQ>

rezultoni se janë përgatitur shablonët e 2 qarqeve, Kukës dhe Dibër, të cilët KQZ i ka vënë në dispozicion.



Prodhimi i materialeve të posaçme zgjedhore për votuesit me aftësi të kufizuara për çdo QV në Republikën e Shqipërisë dëshmon qartazi mospërbushjen e detyrimit ligjor që krerët e njësjive vendore kanë ndaj KQZ-së për dorëzimin e të dhënave të plota mbi Personat me Aftësi të Kufizuara që kanë të drejtë vote, jo më vonë sesa 60 ditë nga data e dekretimit të zgjedhjeve. Mungesa e të dhënave për numrin e saktë të Personave me Aftësi të Kufizuara në listat zgjedhore e bën edhe më të vështirë identifikimin e zgjedhësve të kësaj kategorie sociale që do të marrin pjesë në votimet e 25 Prillit. Të kontaktuar për qëllimet e këtij studimi, Bashkia Tiranë vuri në dispozicion të dhënat e zgjedhësve me aftësi të kufizuara në 14 njësi administrative dhe 13 zona rurale. Referuar këtij burimi, zyrtarisht në Tiranë janë 18 071 zgjedhës që i përkasin këtij komuniteti. Megjithatë institucioni i Bashkisë së Tiranës nuk mundi të vinte në dispozicion shkresa që dëshmonin komunikimin me KQZ dhe njësitë vendore në lidhje me marrjen e masave për numrin specifik të votuesve në QV të vendosur brenda hapsirës administrative të kryeqytetit.

3.2 Çrregjistrimi i kandidatëve me aftësi të kufizuara nga listat për deputetë

Në garë për zgjedhjet parlamentare të 25 Prillit synonte për herë të parë të merrte pjesë edhe një Parti e Personave me Aftësi të Kufizuara. Ky subjekt politik ishte pjesë e koalicionit “Aleanca” i cili depozitoi kërkesën për regjistrim pranë KQZ në 24 Shkurt 2021. Përpos PPAK, në të bënin pjesë edhe 6 forca të tjera përkatësisht: Aleanca Demokratike Shqiptare, Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet, Aleanca e Reformave Demokratike, Aleanca Barazi dhe Drejtësia Europiane, Partia Lëvizja Punëtoresh Shqiptare si dhe Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve. Ky koalicion u çregjistrua për probleme në dokumentacionin provues për plotësimin e nenit 68 të Kodit Zgjedhor⁹, duke pasur vetëm 2 mandate nga 2 subjekte politike në garë dhe asnjë listë mbështetëse me jo më pak se 7 mijë zgjedhës për 5 subjektet e tjera politike. Në mbledhjen e datës 18.03.2021, ku u shqyrtua ankimimi i koalicionit “Aleanca”, përfaqësuesi i tij, z. D. Mullahaj argumentoi se *“partitë pjesëmarrëse në garë duke parë nuk kishin mbështetje me numër mandatesh janë tërhequr nga sigla dhe listat e fundit që janë paraqitur në KQZ janë me dy subjekte”*. Megjithatë vendimi i shfuqizimit të listës shumëmemërore të koalicionit “Aleanca” u la në fuqi nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, z. Ilirjan Celibashi. Duke iu referuar procesverbalit të kësaj mbledhje me dyer të mbyllura, z. Celibashi evidentoi se *“subjekti zgjedhor në fjalë e kishte fituar personalitetin e tij juridik me vendim të KQZ për regjistrimin si koalicion me 7 parti në përbërje. Pjesëmarrja në zgjedhje është e pamundur për më tepër që vetë përfaqësuesi i koalicionit konfirmon se nga 7 parti, 5 prej tyre nuk kanë mundësi të përmbushin kërkesat e ligjit.”*

Nëse nuk do të ishte çrregjistruar, kjo forcë politike do të përfaqësonte një risi në këto zgjedhje parlamentare të 25 Prillit, pasi për të parën herë do të shpalosej një alternativë politike e mirëfilltë nga njerëzit me aftësi të kufizuara me pritshmërinë e ofrimit të zgjedhjeve konkrete për problemet dhe nevojat e tyre. Zgjedhja për t’iu bashkangjitur një koalicioni ishte e diktuar nga pamundësia e kësaj force politike për të gjetur kandidatë për deputetë brenda numrit të mandateve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Konkretisht në pikën 5 të nenit 67 thuhet se *“numri i kandidatëve në listën shumëmemërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse, shtuar dy.”* Partia e Personave me Aftësi të Kufizuara kishte siguruar kandidatë për 1 deri në 2 mandate, vetëm për 4 qarqe të vendit. Kandidatët, sikurse dhe shumica e bordit drejtues të kësaj force politike nuk ishin të

9. Neni 68 i Kodit Zgjedhor, ligji nr.101/2020, “Në rastin e koalicionit zgjedhor listat në tërësi duhet të kenë marrë mbështetjen e jo më pak se 7 000 zgjedhësve në shkallë kombëtare. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë 43 pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit”.

gjithë me aftësi të kufizuara, por ishin persona, të cilët e njihnin nga afër këtë çështje, përmes ndonjë familjari, miku apo i afërmi me aftësi të kufizuara. Pamundësia për të gjetur kandidatë në rradhët e këtij komuniteti në përputhje me numrin e mandateve dhe kriterëve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor tregon për ekzistencën e një barriere të madhe për përfaqësimin politik të Personave me Aftësi të Kufizuara, e cila nuk mund të zgjidhet vetëm përmes përcaktimit të kuotave të përfaqësimit në parlament, njësoj si me barazinë gjinore.


IV. ÇËSHTJET E AFTËSISË SË KUFIZUAR NË FUSHATËN ELEKTORALE

Takimet Elektorale në kushtet e pandemisë e zhvendosën fushatën e PS, PD, LSI dhe NTH kryesisht në mjedise të hapura, megjithëse jo në çdo rast rezultojnë të jetë respektuar protokollin e masave anti-COVID. Në një vëzhgim të posaçëm të “Together for Life”, me mbështetjen e Konrad Adenauer Foundation në Shqipëri, është arritur në përfundimin se partitë politike kanë shkelur në mënyrë të përsëritur masat e përcaktuara nga Komiteti Teknik i Ekspertëve.¹⁰ Kjo fushatë ka pasur një variacion të formave të organizimeve elektorale, që nga tubimet masive në ambiente të hapura, të ulur në karrige ose të parkuar me makina dhe deri tek takimet kokë më kokë me grupe të vogla qytetarësh ose duke trokitur në dyert e shtëpive të tyre. Me përjashtim të një takimi të zhvilluar nga kryetari i Partisë Demokratike me disa shoqata që kujdesen për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në pjesën tjetër të fushatës është vënë re mungesa e takimeve të dedikuara posaçërisht për shqetësimet dhe nevojat e këtij komuniteti. Megjithatë në takimet individuale të kandidatëve me qytetarët, dallojnë disa raste të individëve që prezantohen si pjesë e kësaj kategorie sociale.

Nga monitorimi i përfshirjes së Personave me Aftësi të Kufizuara në fushatat e partive të sipërpërmendura rezultojnë se PD ka numrin më të lartë të takimeve. Në total janë 12 takime elektorale të bëra publike nga kjo forcë politike (5 kandidatë burra dhe 6 kandidatë gra) ku pjesëmarrës kanë qenë individë të punës, në disa raste bashkë me familjet e tyre dhe prindër të fëmijëve me sindromën e spektrit autik. Megjithatë në këto takime është përmendur vetëm 3 herë fjala program, duke iu referuar konkretisht objektivave që PD synon të përmbushë nëse do të vijë në pushtet. Premtimet e artikuluar në këto dy takime janë: a) vendosjen e një standardi evropian në bashkëpunimin me shoqatat e Personave me Aftësi të Kufizuara rikthim të pagesës së kujdestarisë atyre rasteve që u është hequr, b) rritje e ndihmës ekonomike, c) mirëmenaxhim të fondeve të kujdesit social, d) rimbursim të plotë të barnave që merr kjo kategori. Nëntë takimet e tjera dominohen nga gjuha e retorikës politike me akuza për kundërshtarin dhe me premtime individuale të formës së tërthortë të rryshfetit, si për shembull “me ty tani do të merremi ne”, “ti do përfitosh një KEMP më të lartë ashtu sikurse e meriton”, “vajza jote do të futet në punë” etj.

10. Monitorimi i Respektimit të Masave Anti-Covid nga subjektet zgjedhore, TFL dhe KAS, 6 Prill 2021.

Figura 2. Parqitja grafike e frekuencës së takimeve elektorale



Personat me Aftësi të Kufizuara shfaqen me fytyrë dhe prezantohen me emër/mbiemër. Kandidatët e PD synojnë të pasqyrojnë gjendjen e vështirë ekonomike në të cilën ata ndodhen, duke i mëshuar braktisjes së tyre nga institucionet shtetërore. Artikulimi i personave me aftësi të kufizuar në këto takime është minimalist, me përjashtim të një takimi të vetëm të organizuar posaçërisht për kauzat e këtij grupimi social. Në këtë takim, PD nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me shoqatat që përfaqësojnë Personat me Aftësi të Kufizuara për të garantuar vendosjen e një kulture të re bashkëpunimi në frymën e standardeve europiane. Në marrëveshje përmenden disa objektiva që synohen të realizohen, të cilat janë evidentuar edhe në raportin e mëhershëm mbi përfshirjen e çështjeve të Aftësisë së Kufizuar në programet e partive politike. Ajo çka shtohet në marrëveshje është angazhimi i PD për të hetuar dhe ndikimin dhe shkaqet që kanë çuar në hartimin e një legjislacioni diskriminues ndaj Personave me Aftësi të Kufizuar, sikurse pretendon kjo forcë politike. Ashtu sikurse edhe në takimet e tjera të kandidatëve të PD, edhe në këtë takim dominon ligjërimi i drejtuesit politik. Në të evidentohet mjerimi dhe varfëria që ka përfshirë jo vetëm këtë komunitet, por sikurse pretendohet nga opozita e djathtë, të gjithë shoqërinë shqiptare në këto 8 vite qeverisje. Propaganda politike e PD, gjatë kësaj fushate, nuk kursen as vdekjen e një invalidi në karrige me rrota, një javë pasi ishte takuar me një prej kandidatëve për deputete. Në mesazhin publik të kandidatës së kësaj force politike, vdekja i faturohet si përgjegjësi qeverisë së Partisë Socialiste, e cila e kishte braktisur të ndjerin, duke mos i ofruar asnjë shërbim.

E dyta për numrin e takimeve të bëra publike me pjesëmarrës Personat me Aftësi të Kufizuara është Partia Socialiste. Në 4 takimet e evidentuara gjatë monitorimit të fushatës kanë qenë të pranishëm fëmijë me sindromën e spektrit autik, prindërit e tyre si dhe grup aktivistësh nga organizata e personave që nuk shikojnë. Në një nga takimet e PS del në pah edhe përdorimi i procesit të rindërtimit për fushatë elektorale, ku kandidati për deputet i PS viziton familjen e fëmijës me autizëm, shtëpia e të cilit është rindërtuar. Fëmija shfaqet me fytyrë dhe identifikohet me emër në këtë takim. Kandidati nuk artikulon mirëfilli çështje të aftësisë së kufizuar, por premtion që *“qeveria do të punojë për të ofruar kushtet që të gjithë fëmijët të jenë të barabartë”*. Rindërtimi ka përfshirë edhe Qendrën e Zhvillimit të Aftësisë Ndryshe, por në inspektimin e pasqyruar në media, nuk u diskutua asnjë aspekt i planit të veprimit të PS për këtë kategori. I vetmi takim në të cilin artikuloheh premtimet është ai i pasqyruar në median sociale me fëmijët me autizëm. Kandidatja për deputete premtion zgjerim të mjediseve dhe rritje të shërbimeve për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe rritjen e numrit të përfituesve.

Në fushatën e LSI është identifikuar vetëm një takim i bërë publik në median sociale, i cili edhe pse është kryer gjatë fushatës nga një prej kandidatëve të kësaj force nuk duket se ka qëllime elektorale, por sensibilizuese. Rasti i përket një invalidi në karrige me rrota dhe për të prekur ndjeshmërinë e opinionit publik që t'i vijë në ndihmë kandidatja evidenton përmes fotove gjendjen e mjeruar social-ekonomike të tij, duke e identifikuar me emër dhe me zonën e tij të banimit. Në këtë mesazh të kandidatës për deputete nuk bëhet me dije se në çfarë mënyrë do t'u jepet zgjidhje problemeve dhe shqetësimeve të komunitetit të Personave me Aftësi të Kufizuara, por as nuk përdoret gjuha e retorikës politike, sikurse ka ndodhur në takimet elektorale të kolegëve kandidatë të PD, me të cilën janë në koalicion. Ajo u drejton një thirrje njerëzve që të ndërmarrin një akti bamirësie dhe ta ndihmojnë me çfarë mundën këtë individ.

Nisma Thurje ka deklaruar më herët gjatë intervistave me kandidatë që nuk do të kishte takime të dedikuara për këtë kategori. Të vetmet raste ku janë artikuluar publikisht çështjet e aftësisë së kufizuar janë në ditën e prezantimit të kandidatëve ku njëri prej tyre përfaqëson këtë komunitet si dhe në ditën e prezantimit të programit, ku u artikuloan dy nisma ligjore që duan të ndërmarrin nëse do të hyjnë në parlament. Përkatësisht projektligji për aksesueshmërinë në shërbime publike dhe jopublike dhe projekt-ligji për nxitjen e punësimit të kësaj kategorie duke u ofruar lehtësira fiskale biznesit. Të dy këto nisma në fakt janë miratuar dhe janë pjesë e legjislacionit aktual të RSH të përshtatur në frymën e KDPAK.

Figura 3. Takimet Elektorale të PD






Numri i Aktiviteteve për Aftësinë e Kufizuar	Aktiviteti 1	Aktiviteti 2	Aktiviteti 3	Aktiviteti 4	Aktiviteti 5
Vendndodhja	Elbasan, Bar Kafe	Kavajë, banesa e një familje	Greth i Madh Kavajë, banesa e një familje	Marikaj, Bashkia Vorë, banesë e një familje	Tiranë, banesa e një invalidi që jeton vetëm
Data e takimit	5 Mars	10 Mars	4 Mars	13 Mars	20 Mars
Kohëzgjatja	25 sekonda	4 min e 32 sekonda	4 min e 10 sekonda	3 minuta e 40 sekonda	6 minuta e 50 sekonda
Kandidati					
Pjesëmarrës	Dy Persona me Aftësi të Kufizuara	Një person invalid me gjymtyrë të prera dhe familja e tij	Një person invalid me gjymtyrë të prera dhe bashkëshortja e tij	Një person i prezantuar me aftësi të kufizuara	Një invalid me karrige me rrota
Çështje të trajtuara	Përdoret gjuha retorikës politike. Nuk ka asnjë premtim dhe shpalesje të programit	Përdoret gjuha e retorikës politike. Evidentohet situata social-ekonomike e personit dhe braktisja nga shteti. Premtime personale për të përfituar KEMP dhe për të futur vajzën në punë.	Përdoret gjuha e retorikës politike. Evidentohet situata social-ekonomike e personit dhe braktisja nga shteti. Premtime personale për rritje të KEMP në vlerën maksimale.	Përdoret gjuha e retorikës politike. Nuk ka asnjë premtim dhe shpalesje të programit	Përdoret gjuha e retorikës politike. Evidentohet situata social-ekonomike e personit dhe braktisja nga shteti. Asnjë premtim, asnjë shpalesje nga programi

Figura 3. 1. Takimet Elektorale të bëra publike nga PD









Numri i Aktiviteteve për Aftësinë e Kufizuar	Aktiviteti 6	Aktiviteti 7	Aktiviteti 8	Aktiviteti 9	Aktiviteti 10	Aktiviteti 11	Aktiviteti 12
Vendndodhja	Tiranë	Tiranë	Vlorë, bar kafe	Kamëz, banesa e një familje	Tiranë, mjedis i hapur jasht një qendre shërbimesh për fëmijët me autizëm	Tiranë, njësia 3, bar kafe	Tiranë, selia e PD
Data e takimit	27 Mars	2 Prill	5 Prill	6 Prill	2 Prill	6 Prill	13 Prill
Kohëzgjatja	5 min e 30 sekonda	8 min 25 sekonda	4 min e 30 sekonda	4 minuta e 14 sekonda	4 minuta e 55 sekonda	2 min e 90 sekonda	22 Minuta
Kandidati		 					
Pjesëmarrës	Dalje publike e kandidatës për deputetë	Prindër të fëmijëve me autizëm	Persona me Aftësi të Kufizuara	Një qytetar që prezantohet si invalid , banesa e të cilit është dëmtuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019	E ëma dhe motra e një fëmije me autizëm, terapeute dhe drejtuese të një qendre trajtimi për fëmijët me autizëm	Gra, banore të njësisë 3 në kryeqytet	Shoqatat e Personave me Aftësi të Kufizuara
Çështje të trajtuara	Vdekja e invalidit të vizituar në banesë në 20 Mars u cilësua si pasojë e bratisjes së shtetit. Përdoret gjuha e retorikës politike.	Nuk përmendet asnjë premtim konkret, por flitet me gjuhën e retorikës politike. Prindërve u premtohet se shteti do të vi pranë tyre, pa pasur nevojë që ata të trokasin ne dyert e shtetit.	Artikullohet për herë të parë përpara këtij komuniteti, termi "program." Premtohet rritje e ndihmës ekonomike dhe rikthim të pagesës së kujdestarisë atyre rasteve që u është hequr.	Përdoret gjuha e retorikës politike. Nuk përmendet asnjë çështje që lidhet me Aftësinë e Kufizuar. Flitet për përdorimin e programit të Rindërtimit si mjet për blerje votash.	Përmendet çështje që lidhen me vështirësitë ekonomike të trajtimit të fëmijëve me autizëm. Nuk artikullohet asnjë premtim. Flitet me gjuhën e retorikës politike për braktisje nga shteti.	Përmenden çështje që lidhen me aftësinë e kufizuar. Premtohet se do të ketë bashkëpunim me shoqatat. Menaxhim më i mirë i fondeve, subvencionim i plotë i barnave, Përfitim të pagesës së invaliditetit në vlerën reale që u takon.	Premtuhet vendosja e standardit europian të gjithëpërfshirjes në vendimmarrje të Personave me Aftësi të Kufizuara. Nënshkruhet një marrëveshje që pretendohet të vendosë një bashkëpunim të ri me këtë kategori sociale.

Figura 4. Takime elektorale të bëra publike nga PS

Numri i aktiviteteve për Aftësinë e Kufizuar	Aktiviteti 1	Aktiviteti 2	Aktiviteti 3	Aktiviteti 4
Vendndodhja	Elbasan, banesa e rindërtuar e një familje	Tiranë, Qendra e Zhvillimit të Aftësisë Ndryshe	Tiranë, njësia 7, bar-kafe	Durrës, Qendra Komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara
Data e takimit	17 Shkurt	28 Prill	30 Mars	2 Prill
Kohëzgjatja	9 min 44 sekonda	2 min e 30 sekonda	Takim i pasqyruar në median sociale me foto	Takim i Pasqyruar në median sociale me foto
Kandidati				
Pjesëmarrës	Familja e një fëmije me aftësi të kufizuar banon në shtëpinë e rindërtuar.	Inspektim i ecurisë së punimeve nga 2 kandidatë nën petkun e përfaqësuesve të ekzekutivit.	Grup aktivistësh nga organizata e personave që nuk shikojnë	Stafi i Qendrës, prindër të fëmijëve që marrin shërbim në këtë Qendër Komunitare
Çështje të trajtuara	Fëmija shfaqet me fytyrë dhe falenderon qeverinë. Megjithëse takimi është zyrtarisht jashtë fushate, sërish nuk mungon gjuha e retorikës politike për arsytet përse duhet një mandat tjetër. Premtohet që fëmijëve me aftësi të kufizuar t'u sigurohen të njëjta kushte që të jenë barabartë me fëmijët e tjerë.	Përmenden vetëm ndryshimet që do të pësojë nga pikëpamja e zgjerimit infrastrukturor pasi të përfundojë rindërtimi i Qendrës së Zhvillimit të Aftësisë Ndryshe.	Nuk përmendet çështje konkrete të aftësisë së kufizuar por flitet në emër të këtij grupimi që ka garantuar se do mbështesë PS pasi është e vetmja forcë që do t'u gjej zgjidhje nevojave të tyre.	Aktualisht janë 105 fëmijë që marrin shërbime në këtë Qendër. Premtohet zgjerimi i mjediseve, shtimi i shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara dhe rritja e numrit të përfituesve.

Figura 5. Takime Elektorale të bëra publike nga LSI




Numri i Aktiviteteve për Aftësinë e Kufizuar	Aktiviteti 1
Vendndodhja	Tiranë, Nisht-Tulla
Data e Takimit	28 Mars
Kandidati	
Kohëzgjatja	Takim i Pasqyruar në median sociale me foto
Pjesëmarrësit	Një invalid në karrige me rrota
Çështje të trajtuara	Pasqyrohet gjendja e vështirë social-ekonomike e këtij personi me aftësi të kufizuara dhe braktisja e tij nga institucionet shtetërore. I bën apel humanizmit të shoqërisë për ta ndihmuar këtë rast. Nuk paraqet asnjë plan apo objektiv të LSI për këtë kategori.

Figura 6. Takime Elektorale të bëra publike nga Nisma Thurje

Numri i Aktiviteteve për Aftësinë e Kufizuar	Aktiviteti 1	Aktiviteti 2
Vendndodhja	Tiranë	Lezhë
Data e Takimit	31 Mars	6 Mars
Kandidati		
Kohëzgjatja	51 minuta nga të cilat 1 min e 30 sekonda kushtuar Aftësisë së Kufizuar	1 orë e 37 minuta nga të cilat 2 min e 30 sekonda i kushtohet Aftësisë së Kufizuar
Pjesëmarrësit	Drejtuuesit politikë në rrethe të partisë. Prezatur në FB	Kandidatët për deputetë
Çështje të trajtuara	Premtohet pr/ligji për aksesueshmërinë në të gjitha godinat publike. Premtohet një pr/ligj për ofrimin e lehtësirave fiskale për bizneset që punësojnë persona me aftësi të kufizuara	Kërkohet më shumë përfaqësim në vendimmarrje me njerëz që kanë në vëmendje çështjet e aftësisë së kufizuar në parlament. Nuk artikullohet asnjë nisëm ligjore që synohet të ndërmerren nga kjo forcë për këtë kategori sociale.

V. PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË LISTAT E KANDIDATËVE

Studiuesit kanë identifikuar faktorë të ndryshëm, të cilët shpjegojnë se përse në vende të zhvilluara demokratike, grupe të caktuara në shoqëri janë ende të nënpërfaqësuar në politikë dhe përse disa kategori të tjera janë të mbipërfaqësuar. Faktorët i kanë rënë në tyre tek normat kulturore mbi racën dhe gjininë dhe fuqinë e institucioneve.¹¹ Referuar një studimi të vitit të fundit (Evans/Reher 2020) rezulton se partitë pretendojnë shpesheherë se rekrutimi politik në rradhët e kategorive të disavantazuara është një sipërmarrje e vështirë në kushtet kur ka pak “ofertë”, ndërsa vetë kandidatët shfaqen të tërhequr për shkak të formave të ndryshme të diskriminimit që nxjerrin në pah nivelet e ulëta të përvojës dhe ambicies politike. Edhe pse studimi i sipërcituar është kryer në një kontekst tjetër social-ekonomik sikurse ai i Britanisë së Madhe ku numërohen 51 Persona me Aftësi të Kufizuara që janë politikanë, kandidatë, apo të gatshëm për të qenë përfaqësues të komunitetit në zgjedhjet lokale, sërish ekzistojnë ngjashëri me kontekstin shqiptar, ku në fakt nuk flitet për nënpërfaqësim por për mungesë totale përfaqësimi në institucione të zgjedhura. Në Shqipëri, ashtu si në shumë vende të tjera, është diskriminimi ndaj këtij komuniteti social që redukton hapësirat për përfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në listat e kandidatëve. Një prej tyre, me dëshirën dhe përgatitjen arsimore për të përfaqësuar komunitetin e tij në këto zgjedhje, tregon se partitë tradicionale shqiptare nuk janë shumë të hapura për të pritur kandidatë “ndryshe” sikurse ai:

- ◆ “Do kisha dashur të angazhohesha në parti që kanë më shumë influencë, të ashtuquajturat parti të mëdha, qofshin këto në qeveri apo opozitë, por për fat të keq, partitë tradicionale nuk janë fort të hapura ndaj ndryshimit. Pra, duan medoemos një kandidat ose një person, jo thjesht të besueshëm, por një person që e njohin mirë dhe që kanë punuar me të.” (Intervista me aktivistin me aftësi të kufizuara)

Megjithatë i njëjti aktivist politik i intervistuar nuk fsheh të dyja anët e medaljes së realitetit shqiptar kur flitet për pengesat që kanë Personat me Aftësi të Kufizuara kur bëhet fjalë për t’u angazhuar politikisht në nivele të larta vendimmarrëse.

11. Disability and political representation: Analysing the obstacles to elected office in the UK, Elizabeth Evans, Stefanie Reher, 6 October 2020.

- ◆ “Për fat të keq një përqindje e lartë e Personave me Aftësi të Kufizuara, për shkak të vështirësive në zonat ku janë lindur dhe janë rritur apo edhe ndjeshmërisë, paragjykimeve, e kanë pasur të pamundur të ndjekin arsimin e mesëm ose të lartë. Për këtë arsye një nga pengesat kryesore për angazhimin politik të kategorisë sonë është edhe kjo. Në bazë të statistikave, një pjesë shumë e vogël e njerëzve me aftësi të kufizuara e kanë pasur mundësinë të ndjekin arsimin e lartë. Por edhe në ato raste kur persona të këtij komuniteti kanë kualifikimet e duhura sërish kanë dilema, pasi shumë prej nesh janë keqtrajtuar nga politika. Mund të thuhet se politika perceptohet si fobi në vetvete.” (Intervista me aktivistin me aftësi të kufizuara)

Skepticizmi që përmendet në pohimin e mësipërm i mban dukshëm Personat me Aftësi të Kufizuara larg kandidimit nën siglën e partive të ndryshme politike. Një prej tyre, i cili ka vendosur t'i atashohet lëvizjes më të re politike në këto zgjedhje, Nismës Thurje, shpjegon edhe arsyet që e kanë çuar drejt këtij vendimi. Kandidati për deputet i forcës së re politike nënvizon rëndësinë që ka për komunitetin e Personave me Aftësi të Kufizuara që të ndihen të pranuar dhe të dëgjohen brenda një organizate politike, ashtu si edhe në çdo instancë publike vendimmarrëse. Është pikërisht ky motivi që e nxit atë të ndër marr këtë hap, me jo pak sakrificë.

- ◆ “Kjo parti është krijuar nga disa të rinj. Në fakt nuk është tamam parti aktualisht, por kur të hyjë në parlament do të ndryshojë emërtesën e saj. Unë e kam zgjedhur të jem pjesë e kësaj lëvizje sepse aktivizimi i thjeshtë. Mjafton të kishe dëshirë të bëheshe vullnetarisht pjesë e saj. Nuk ka asnjë kriter si shkollën e lartë ose kualifikime të tjera. Duhet vetëm të jesh aktiv, të japësh mendimet, opinionet dhe ato të dëgjojnë....Unë kam pamundësi fizike dhe të jem i sinqertë e kam pak të vështirë, megjithatë unë do t'ia arrijë qëllimit që të bëj zërin e kategorisë sonë të dëgjohet. Njerëzit me Aftësi të Kufizuara në Shqipëri, mendoj se nuk janë të mbështetur nga qeveria, dhe nuk i marrin parasysh opinionet e tyre. Ata nuk janë të pallogaritur. Kanë dëshirë të japin mendimin e tyre për një problematikë të veten dhe nuk dëgjohen fare...por janë si të përjashtuar.” (Intervista me kandidatin për deputet të NTH)

Megjithatë të bindësh personat me aftësi të kufizuara mund të jetë e vështirë edhe për një kandidat që vjen nga ky grupim social dhe e di çdo të thotë “jesh në lëkurën” e atij që përballet çdo ditë me pengesa. Intervista me aktivistin që synonte të prezantonte kandidaturën e tij në këto zgjedhje, partia e të cilit u çregjistrua për mospëmbushje të kriteve në Kodin Zgjedhor, nxjerr në pah pikërisht këtë fakt.

- ◆ “Për të synuar votën tek këto persona, duke pasur parasysh se janë zhgënjyer nga të gjitha partitë deri më tani, është e vështirë t'i bindësh. Ndaj nevojitet

një plan sa më i qartë me objektiva të arritshme, pra jo premtime që ngelen thjesht në letër. Pavarësisht se shumica e Personave me Aftësi të Kufizuara nuk e kanë ndjekur dot shkollimin, ata janë shumë të zgjuar. Kanë një dhunti të pakrahasueshme kundrejt çfarëdolloj aftësie të kufizuar për të perceptuar dhe ndjerë vërtetësinë në qasjen e kandidatëve dhe partive politike përballë tyre.” (Intervista me aktivistin me aftësi të kufizuara)

Ndjeshmëria e tyre preket në detaje të vogla, mbase jo fort të dallueshme nga të gjithë, por që për Personat me Aftësi të Kufizuara do të thotë shumë:

- ◆ “Unë i kisha shkruar një koment deputetes së zonës sime. Ajo kishte bërë një mbledhje me përfaqësues të administratës lokale ndërkohë që e kishte pasqyruar në median sociale sikur ishte takuar me qytetarë, njerëz të ndryshëm. Unë i shkruajta që çdo ardhje e juaja duhet të jetë publike që edhe ne të dalim dhe të themi diçka që nuk na pëlqen, që duam ta ndryshojmë sepse jo çdokush është në rregull me çdo gjë. Ajo më kishte fshirë komentin dhe më kishte bërë dhe bllok në FB.” (Intervista me kandidatin për deputet të NTH)

Megjithëse është për t’u vlerësuar fakti se në këtë garë për të parën herë ka edhe kandidatë që i përkasin këtij grupimi social, jo të gjithë e mendojnë përfaqësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar si një mundësi reale. Disa sepse nuk ndihen pjesë e këtij komuniteti edhe pse kanë një kufizim konkret që i pengon të aksesojnë procese të ndryshme si gjithë të tjerët, ndërsa të tjerë sepse nuk besojnë se do të arrijnë të zgjidhen.

- ◆ “Jo nuk besoj se do fitojë. Unë e mendoj si diçka të pamundur dhe të jem i sinqertë jam krejtësisht i papërgatitur për këtë gjë.” (Intervista me kandidatin për deputet)
- ◆ “Unë nuk jam i përfshirë fare tek personat me aftësi të kufizuar. Unë kam kufizime fizike por nuk kam pranuar asnjëherë çështje të tilla” (Pohim i një tjetër kandidat për deputet që nuk identifikohet si Person me Aftësi të Kufizuara)

Të dyja këto pohime dëshmojnë për peshën e diskriminimit që ndër vite i ka bërë Personat me Aftësi të Kufizuara të mos besojnë në potencialin e tyre, ose të mos duan të identifikohen me këtë komunitet për të shmangur stereotipet që shoqëria ka krijuar për ta mbi bazën e konceptit të “aftësisë”¹² që përcakton nëse një kandidat për deputet apo një i zgjedhur në pushtetin vendor duhet të jetë me aftësi fizike dhe mendore për të qenë pjesë e kulturës politike ekzistuese.¹³ Diskriminimi ndaj Personave me Aftësi të

12. Aftësia - supozimi se kandidatët politikë duhet të jenë të aftë mendërisht dhe të jenë në gjendje të përshtaten me kulturën ekzistuese politike.

13. Waltz, Mitzi, Schippers, Alice., (2020), Politically Disabled: Barriers and facilitating factors affecting people with disabilities in political life within the European Union.

Kufizuara është i përhapur në shumë vende të zhvilluara, por në shoqëritë me më pak vetëdije dhe mbështetje për kauzat e kategorive të marginalizuara, sikurse shoqëria shqiptare, mundet që presioni mbi kandidatët që vijnë nga ky komunitet të jetë edhe më i madh për shkak të mungesës së një sistemi të drejtë dhe transparent të vlerësimit dhe rekrutimit të elementëve të rinj nga partitë politike.

VI. KONKLUZIONE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë masa për sigurimin e materialeve zgjedhore për zgjedhësit me aftësi të kufizuara. Pavarësisht vonesave për shkak të problemeve teknike me fletën e votimit, burime zyrtare të KQZ konfirmojnë se ka nisur tashmë prodhimi i të gjitha fletëve të votimit mes tyre edhe të shabllonit për zgjedhësit që nuk shikojnë, të cilat besohet se do të jenë gati për të 12 qarqet në 22 Prill, afati i përcaktuar për dorëzimin e tyre nga kompania sllovene.

Edhe në këto zgjedhje ka munguar koordinimi mes KQZ dhe njërive vendore të RSH për të sjellë numrin e saktë të zgjedhësve me aftësi të kufizuara që votojnë në çdo zonë zgjedhore. Në këto kushte KQZ është detyruar të prodhojë materiale zgjedhore të posaçme për zgjedhësit e kësaj kategori sociale për 5199 QV-të në gjithë vendin.

Nga monitorimi i fushatës elektorale të PD, PS, LSI dhe NTH shumë pak kohë i është dedikuar posaçërisht çështjeve të aftësisë së kufizuara dhe takimeve me elektoratin e këtij grupimi social. Nga këto forca politike, PD ka numrin më të lartë të takimeve me individët me aftësi të kufizuara.

Në takimet elektorale të të 4 forcave politike dominon gjuha e retorikës dhe propagandës, ndërsa shumë pak aspekte të programit electoral janë bërë publike. Ajo çka bie në sy kryesisht janë premtime personale për rritje të KEMP-it, për futje në punë të familjarëve, apo edhe për caktimin e pagesës së kujdestarisë, atyre individëve që iu është hequr. Kompetenca këto të cilat nuk lidhen mirëfilli me atributet ligjore që Kushtetuta i njej deputetit.

Personat me Aftësi të Kufizuara portretizohen në takimet elektorale të partive si njerëz të braktisur në varfëri ekstreme, të cilët ngjallin mëshirë për gjendjen e rënduar social-ekonomike në të cilën ndodhen. Ato shfaqen me fytyrë dhe identifikohen me emër – mbiemër dhe zonë banimi, duke mos përjashtuar nga kjo praktikë as të miturit që janë me sindromën e spektrikt autik.

Në këto zgjedhje për herë të parë kandidojnë edhe Persona me Aftësi të Kufizuara, por jo të gjithë pranojnë të identifikohen se i përkasin këtij grupimi social, duke dëshmuar për peshën e rëndë të diskriminimit që ndihet në shoqëri ndaj kandidatëve me aftësi të kufizuara.

VII. REKOMANDIME

Njësitë vendore përgjegjëse për identifikimin e zgjedhësve me aftësi të kufizuara duhet të koordinohen me KQZ për ofrimin e një baze të dhënash të saktë për këtë kategori zgjedhësish që nuk votojnë dot vetëm.

KQZ duhet të pajis me gjuhën e shenjave spotin e ri të publikuar para 1 jave për respektimin e masave anti-COVID në Qendrat e Votimit.

Fushata elektorale duhet të përqëndrohet më shumë tek Personat me Aftësi të Kufizuara, jo për t'i portretizuar si njerëz të mjerë dhe të braktisur, por për të evidentuar në mënyrë dinjitoze problemet që kanë, duke u respektuar privatësinë, veçanërisht nëse janë të mitur.

Partitë politike të monitoruara gjatë fushatës duhet të jenë më konkrete me premtimet e tyre dhe të shpjegojnë rrugëzgjdhjet që propozojnë për problemet dhe nevojat e këtij grupimi social.

Në takimet elektorale me Personat me Aftësi të Kufizuara duhet të shmangët gjuha e retorikës politike dhe e dhunës verbale drejtuar kundërshtarit në këtë garë. Nuk duhet harruar ndjeshmëria dhe kujdesi me të cilën duhet t'i drejtohen elektoratit me aftësi të kufizuara.

Rritja e numrit të Personave me Aftësi të Kufizuara si të zgjedhur në institucione vendimmarrëse, sikurse parlamenti i RSH, është e lidhur jo thjesht me vendosjen e kuotave, por me një seri reformash që duhet së pari të rrisin numrin e personave me aftësi të kufizuara që kanë mundësi të vijojnë studimet e larta, të kualifikohen dhe të mos ndiejnë peshën e paragjyqimit për përfaqësimin e komunitetit të tyre në parlament.

Referencat

Raporti i OSBE-ODHIR për zgjedhjet parlamentare të 25 Qershorit 2017

Padia e PR në Gjykatën Kushtetuese e bërë publike në media, <https://top-channel.tv/2021/03/09/tubimet-elektorale-gjykata-kushtetuese-pranon-pjeserisht-kerkesen-e-pr4/>

Pika 3/b e nenit 5 të Udhëzimit nr.1 PËRCAKTIMI I RREGULLAVE PËR NGRITJEN, CAKTIMIN DHE NJOFTIMIN E VENDNDODHJES SË QENDRAVE TË VOTIMIT DHE PËRGATITJEN E HARTËS SË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE PËR ZGJEDHJET, 05 Dhjetor 2020.

Monitorimi i Respektimit të Masave Anti-Covid nga subjektet zgjedhore, TFL dhe KAS, 6 Prill 2021

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë

Waltz, Mitzi, Schippers, Alice., (2020), Politically Disabled: Barriers and facilitating factors affecting people with disabilities in political life within the European Union.

Disability and political representation: Analysing the obstacles to elected office in the UK, Elizabeth Evans, Stefanie Reher, 6 October 2020

Linqet në Youtube të Spoteve Informuese të KQZ të përgatitura me gjuhën e shenjave për identifikimin elektronik të votuesve, veprat penale që çënojnë zgjedhjet e këtij viti, procedurat e votimit dhe KQZ-fleta e votimit

<https://www.youtube.com/watch?v=RXkn-0PIU80>

<https://www.youtube.com/watch?v=S5lq91h9aL8>

<https://www.youtube.com/watch?v=uHINp7vBXjs>

<https://www.youtube.com/watch?v=2n7dscRR7HQ>